

KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE – KESH SH.A.
PASQYRA E KONSOLIDUAR E POZICIONIT FINANCIAR
31 DHJETOR 2017

(Shumat janë të shprehura në mijë Lek)

		Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2017	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2016
Shënime			
AKTIVET			
Aktive afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	6	96.300.575	94.554.371
Aktive afatgjata jomateriale		48	52
Aktive financiare	9	12.690.077	14.877.806
		108.990.700	109.432.229
Aktive afatshkurtra			
Inventarë	8	2.521.038	2.488.688
Aktive financiare	9	7.348.378	6.131.430
Llogari të arkëtueshme e të tjera	7	52.743.346	53.551.762
Parapagime dhe shpenzime të shtyra		49.063	47.438
Mjete monetare në arkë e bankë	10	796.783	805.336
		63.458.609	63.024.653
Totali i aktiveve		172.449.309	172.456.882
KAPITALI			
Kapitali aksioner dhe rezervat			
Kapitali aksioner	11	20.174.222	20.174.222
Reduktim i paregjistruar kapitali	11	(4.000)	(4.000)
Rezerva të tjera		68.893.553	70.072.200
Rezerva ligjore		2.657.219	2.657.219
Fitimi (humbja) e mbartur		(14.360.965)	(16.672.219)
Fitimi (humbja) e vitit		(52.727)	1.159.337
Totali i kapitalit		77.307.302	77.386.759
DETYRIME			
Detyrime afatgjata			
Kredi dhe hua	13	28.532.506	30.481.252
Tatimi i shtyrë mbi fitimin	14	481.696	507.576
Grante qeveritare	15	119.618	131.152
Detyrime të tjera afat-gjata	12	810.147	810.147
		29.943.967	31.930.127
Detyrime afatshkurtra			
Llogari të pagueshme dhe të tjera	12	13.785.556	18.033.501
Kredi dhe hua	13	51.412.485	45.106.494
		65.198.041	63.139.995
Totali i detyrimeve		95.142.008	95.070.122
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		172.449.309	172.456.882

Pasqyrat financiare të konsoliduara u aprovuan më 15 Maj 2018 dhe u firmosën si më poshtë:

ADMINISTRATORI

DREJTORE E
DEPARTAMENTIT
EKONOMIK

SHEFI I SEKTORIT TË
KONTABILITETIT

Agron HETOJA

Enkelejda MYFTARI

Eftiola TEKTO

KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE – KESH SH.A
PASQYRA E KONSOLIDUAR E TË ARDHURAVE GJITHEPËRFSHIRESE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2017

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2017	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2016
<i>(Shumat janë të shprehura në mijë Lek)</i>			
Operacionet e vijueshëm			
Të ardhura	16	7,289,888	16.521.118
Të ardhura të tjera	17	3,923,611	752.774
Materiale të para dhe të konsumueshme		(115,600)	(120.392)
Blerje energjie	22	(3,647,021)	(8.279.508)
Shpenzime personeli	18	(949,027)	(1.040.654)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	6	(2,575,095)	(2.446.125)
Humbje nga rënia në vlerë		(1,043,003)	(331.217)
Shpenzime të tjera	19	(1,937,076)	(1.742.086)
Fitimi operativ		946,678	3.313.910
 Të ardhura financiare	20	1,454,213	439.301
Shpenzime financiare	20	(1,894,717)	(1.966.395)
Shpenzime financiare neto		(440,504)	(1.527.095)
 Fitimi para tatimit		506,174	1.786.815
Kreditim i tatimit mbi fitimin	21	25,880	127.534
Shpenzime tatim fitimi		(584,781)	(755.011)
Fitimi neto i periudhës nga operacionet e vijueshëm		(52,727)	1.159.337
 Fitimi neto i periudhës		(52,727)	1.159.337
 Të tjera të ardhura gjithëpërfshirëse			
Shtesë/(pakësim) në rezervën e rivlerësimit			20.335
 Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse			
Aksionerë të Shoqërisë		(52,727)	1.179.672
		(52,727)	1.179.672

Pasqyrat financiare të konsoliduara u aprovuan më 15 Maj 2018 dhe u firmosën si më poshtë:

ADMINISTRATORI

Agron HETOJA



DREJTORE E
DEPARTAMENTIT
EKONOMIK

Enkelejda MYFTARI



SHEFI I SEKTORIT TË
KONTABILITETIT

Eftiola TEKTO



KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE – KESH SH.A.
PASQYRA E KONSOLIDUARA E FLUKSEVE MONETARE PER VITIN E
MBYLLUR ME 31 DHJETOR 2017

<i>(Shumat janë të shprehura në mijë Lek)</i>	Shëni me	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2017	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2016
Flukset e parasë nga aktivitetet operative			
Flukset e parasë përdorur në aktivitetet operative	23	172,835	2.898.796
Interesa të paguara		(1,285,136)	(1.414.803)
Tatimi i paguar mbi fitimin			
Flukset neto të parasë përdorur në aktivitetet operative		(1,112,301)	1.483.993
Flukset e parasë nga aktivitetet investuese			
Blerje e aktiveve afatgjata materiale		(4,549,755)	(3.052.641)
Hua dhënë palëve të treta		(4,127,935)	(1.797.163)
Shlyerje të kredive nga palë të treta		4,395,105	3.102.681
MM te op. Jo te vijueshem te nxj. j.p.			23.110
Interesa të arkëtuara		41,483	194.167
Flukset neto të parasë përdorur në aktivitetet investuese		(4,241,101)	(1.529.845)
Flukset e parasë nga aktivitetet financuese			
Të ardhura nga huamarrjet		3,871,602	2.921.205
Shlyerje e huamarrjeve		(889,133)	(1.528.162)
Të ardhura nga grantet		(6,923)	
Flukset neto të parasë nga aktivitetet financuese		2,975,546	1.393.043
Rritja (+)/rënia(-) neto e mjeteve monetare		(2,377,856)	1.347.191
Mjete monetare në fillim të periudhës kontabël		(30,759,163)	(32.106.354)
Mjete monetare në fund të periudhës kontabël	10	(33,137,019)	(30.759.163)

Pasqyrat financiare të konsoliduara u aprovuan më 15 Maj 2018 dhe u firmosën si më poshtë:

Administratori

Agron HETOJA



Drejtores e Departamentit
Ekonomik

Enkelejda MYFTARI



Shefi i Sektorit të
Kontabilitetit

Eftiola TEKO



KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE – KESH SH.A
PASQYRA E KONSOLIDUAR E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2017

KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE KESH SH.A.
PASQYRA E KONSOLIDUAR E E NDRYSHIMEVE NE KAPITAL

(Shumat janë të shprehura në mijë Lek)

	Kapitali aksionar	Reduktim i paregjistruar kapitali	Aksionarët e Shoqërisë	Fitim/ (Humbje) të mbartura	Totali i kapitalit
			Rezerva të tjera	Rezerva ligjore	
Gjendja më 31 Dhjetor 2014 (Riparaqitur)	20,040,097	(4,000)	59,676,712	2,657,219	(19,873,596)
Të ardhura neto për periudhën					797,046
Shtesë në rezervë nga rëlerësimi i aseteve viti 2015			12,774,034		12,774,034
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse	-	-	12,774,034	-	13,571,080
Zmadhim kapitali Urdhëri nr. 544/1, datë 11.02.2015; Urdhëri nr.2549/1, datë 16.04.2015.	134,125				
Sistemim i rezervës së rëlerësimi të aseteve për vitin 2015			(1,213,765)		1,213,765
Sistemim i rezervës së rëlerësimi të aseteve për asetet e nxjerra jashtë bilanci			(407)		419
Shpërndarja e rezultatit të vitit 2014 shkresa nr.5870/1 date 30.07.2015					12
Transaksione me pronarët	134,125	-	(1,214,172)	-	134,137
Gjendja më 31 Dhjetor 2015	20,174,222	(4,000)	71,236,574	2,657,219	(17,862,365)
Të ardhura neto për periudhën					1,159,337
Shtesë në rezervë nga rëlerësimi i aseteve viti 2016			20,335		20,335
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse	-	-	20,335	-	1,179,672
Sistemim i rezervës së rëlerësimi të aseteve për vitin 2016			(1,190,147)		-
Rezerve Rëlerësimi			5,437		5,437
Shpërndarja e rezultatit të vitit 2015					-
Transaksione me pronarët	-	-	(1,184,710)	-	5,437
Gjendja më 31 Dhjetor 2016	20,174,222	(4,000)	70,072,199	2,657,219	(15,512,881)
Të ardhura neto për periudhën					77,386,759
Shtesë në rezervë nga rëlerësimi i aseteve					(52,727)
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse	-	-	-	-	(52,727)
Sistemim i rezervës së rëlerësimi të aseteve për vitin 2016			(1,151,916)		1,151,916
Vendimit të Asamblese nr.5.dt.8.9.2017			(26,730)		(26,730)
Shpërndarja e rezultatit					-
Transaksione me pronarët	-	-	(1,178,646)	-	(26,730)
Gjendja më 31 Dhjetor 2017	20,174,222	(4,000)	68,893,553	2,657,219	(14,413,692)
					77,307,302

Pasqyrat financiare të konsoliduara u aprovuan më 15 Maj 2018 dhe u firmosën si më poshtë:

ADMINISTRATORI

DREJTORE E DEPARTAMENTIT EKONOMIK

SHEFI I SEKTORIT TË KONTABILITETIT

Agron HETOJA

Enkelejda MYFTARI

Eftiola TEKO

Shënimet shpjeguese janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

1. Informacion i përgjithshëm

Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Sh.a dhe Shoqëritë e kontrolluara prej saj (së bashku "KESH" ose "Grupi") u themelua si një shoqëri anonime me aksione më 31 Dhjetor 1994. Ministria e Energjisë dhe Industrisë, referuar VKM 317, datë 27.04.2016 është përfaqësuesi i shtetit si pronar i 100% i kapitalit aksioner të KESH-it.

Më 31 Dhjetor 2017, Grupi zotëronte aksionet e shoqërive 'KESH Security SHRSF' Sh.a. ("KESH Security") dhe "Termocentrali Vlorë" Sh.a. ("TEC Vlorë"). KESH Security u themelua më 7 Prill 2008 bazuar në vendimin nr 14 të Këshillit Mbikëqyrës të Grupit dhe ushtron aktivitetin në sigurimin e shërbimeve të ruajtjes për Grupin. Në bazë të vendimit numër 15 date 28.09.2015 Këshilli mbikqyrës i KESH sh.a në cilësinë e aksionerit të vetëm ka vendosur prishjen në gjendjen e aftësisë paguese të shoqërisë "KESH Security SHRSF" Sh.a. Me vendimin nr. 2 datë 07.10.2015 të administratorit të KESH sha, në cilësinë e përfaqësuesit të aksionerit të vetëm ka vendosur emërimin e likuidatorit dhe lirim të detyrës të administratorit.

Tec Vlorë është krijuar juridikisht me vendimin e gjykatës nr. 3862 datë 18/06/2007, si një shoqëri tërësisht e kontrolluar nga KESH sh.a dhe veprimtaria kryesore e tij është prodhimi i energjisë.

Shoqëria KESH sh.a në zbatim të parashikimeve të Ligjit 43/2015 "Per sektorin e energjisë elektrike" VKM Nr.244/2016, i ndryshuar, Vendimeve të Bordit të ERE Nr.112/2016, Nr. 194/2016, Nr.52/2017 dhe Nr.62/2017 përmbushi detyrimin për shërbim publik përkundrejt OSHEE sh.a/FSHU/OSSH (për furnizimin e energjisë elektrike për nevojat të Furnizimit të Shërbimit Universal dhe pjesërisht për furnizimin e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes) si edhe përkundrejt OST sh.a/OST (për mbulimin e humbjeve në sistemin e transmetimit dhe sigurimin e shërbimit për balancimin e sistemit (kapacitet dhe energji balancuese)).

Për periudhën Janar -Dhjetor 2017, Bordi i ERE nëpërmjet vendimit Nr.190, datë 22.12.2016 që la në fuqi vendimin Nr. 139, datë 26.12.2014 (respektivisht, tarifën e shitjes së energjisë elektrike nga KESH sh.a tek OSHEE sh.a (1.45 lekë/kWh) dhe së fundmi vendimit Nr.194, datë 30.12.2016 i cili la në fuqi tarifën 1.45 lekë/kWh për shitjen e energjisë elektrike tek OST sh.a për mbulimin e humbjeve në sistemin e transmetimit dhe tarifën 158 lekë/MW/h për shërbimet ndihmëse.

KESH sh.a. aktualisht përbëhet nga 3 njësi prodhuese hidro-energjetike, KESH Security, TEC Vlorë dhe Administrata Qëndrore. Shoqëria e ka adresën zyrtare në Shqipëri. Adresa e zyrës së saj të regjistruar është Blloku Vasil Shanto, Kutia postare 259/1, Tiranë, Shqipëri.

2. Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të publikuara nga Bordi i Standarteve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("IASB") dhe interpretimeve të publikuara nga Komiteti i Interpretimeve të Raportimeve Financiare Ndërkombëtare ("IFRIC") të IASB.

Pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur bazat e vlerësimit të specifikuara nga SNRF për çdo klasë të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave gjithpërfshirëse. Bazat e matjes përshkruhen në detaje në politikat kontabël të më poshtme.

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon përdorimin e disa çmuarjeve kritike kontabël. Gjithashtu kjo kërkon që drejtimi të përdorë gjykimin e tij në procesin e përdorimit të politikave kontabël të Shoqërisë. Fushat që përfshijnë një nivel të lartë gjykimi apo kompleksiteti ose fushat ku supozimet dhe çmuarjet janë të rëndësishme për pasqyrat financiare paraqiten në shënimet përkatësisht. Pasqyrat financiare janë përgatitur për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017.

Të dhënat aktuale në këto pasqyra financiare janë të shprehura në mijë Lek ('000 LEK).

2. Bazat e përgatitjes (vazhdim)

(a) Krahasueshmëria

Informacioni krahasues paraqitet në mënyrë të vazhdueshme, duke aplikuar politikat kontabël të Shoqërisë dhe duke u bazuar në modelin e pasqyrave financiare sipas Standarteve Nderkombetare të Raportimit Financiar.

(b) Ndryshimet në politikat kontabël

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me ndryshimet e kërkesave për dhënie informacioni. Standartet e reja, amendimet e standarteve dhe interpretimeve të paraqitura më poshtë, janë të detyrueshme për zbatim në pasqyrat financiare për vitin që fillon më 1 Janar 2017, por që nuk pritet të sjellin ndryshime të rëndësishme në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

Ndryshime në SNK 7 “ Pasqyra e Levizjes së Parasë”- Iniciativa e informacioneve shpjeguese (efektive për periudhat vjetore duke filluar në ose pas datës 1 Janar 2017)

Ndryshime në SNK 12 “Tatimi mbi të Ardhurat” – Njohja e aktiveve tatimore të shtyra për humbjet e parealizuar (efektive për periudhat vjetore duke filluar në ose pas datës 1 Janar 2017)

Ndryshime në SNRF 12 si pasojë e “Përmirësimeve të SNRF-ve (cikli 2014-2016)” rezultuar nga projekti i përmirësimit vjetor të SNRF (SNRF 1, SNRF 2, dhe SNK 28) kryesisht me një pikëpamje për të eliminuar mospërputhjet dhe për të qartësuar formulimin (ndryshimet mbi SNRF 12 do të jenë të aplikueshme për periudhat vjetore duke filluar në ose pas datës 1 Janar 2017).

Amendimet e SNK 19 “Përfitimet e Punonjësve”

(emetuar në Dhjetor 2015 dhe efektiv për periudhat që fillojnë me 1 Janar 2016)

Amendimi në SNRF 36, “Dhenia e informacionit mbi shumat e rikuperueshme për aktivet jo-financiare”
(Emetuar në Maj 2013 dhe efektiv me ose pas 1 Janar 2014)

Aplikimi i mëparshëm është i lejuar nëqë është aplikuar SNRF 13 për periudhën kontabël dhe periudhën krahasuese. Standardi i amenduar nuk ka një impakt material në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

Amendimi në SNRF 39, “Zëvendësimi i Derivateve dhe vijimesia e Kontabilitetit Mbrojtës” (Emetuar në Qershor 2013 dhe efektiv më ose pas 1 Janar 2014).

SNRF 9 Instrumentat Financiare (Efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2018)

SNRF 9 Instrumentat Financiare – Vecoritë e parapagimit me Kompensim Negativ *(Efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2019)*

SNRF 9 është standarti i parë i lëshuar si pjesë e një projekti më të gjerë për të zëvendësuar SNK 39.

SNRF 9 Ruan, por thjeshton modelin e përzier të matjes dhe krijon dy kategori kryesore të matjes për aktivet financiare: koston e amortizuar dhe vlerën e drejtë. Baza e klasifikimit varet nga modeli i aktivitetit të tij si dhe karakteristikat kontraktuale të fluksit të mjeteve monetare të aktivitetit financiar. Udhëzimi në SNK 39 për zhvlerësimin e aktiveve financiare dhe kontabilitetin mbrojtës vazhdon të zbatohet.

SNK 27 “Pasqyrat Financiare Individuale

(Emetuar me 12 Gusht 2014 dhe efektiv për periudhat që fillojnë më 1 Janar 2016)

2. Bazat e përgatitjes (vazhdim)

(b) Ndryshimet në politikat kontabël (vazhdim)

SNK 27 *(rishikuar në 2011)* përfshin kërkesa në lidhje me pasqyrat financiare individuale.

SNK 28 **“Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta - Interesa afatgjatë në Pjesëmarrje dhe Ndërmarrje të Përbashkëta (efektiv më ose pas datës 1 Janar 2019),**

Amendime në SNRF 11, Kontabilizimi për blerjet e interesave në Operacionet e Përbashkëta *(Emetuar më 6 Maj 2014 dhe efektiv për periudhat që fillojnë më ose pas 1 Janar 2016).*

Amendimi në SNRF 14, Llogarite rregullatore e shtyrjes
(Emetuar në Janar 2014 dhe efektiv për periudhat që fillojnë më ose pas 1 Janar 2016).

Amendime në SNRF 16 “Qiratë”, *(efektiv për periudhat më ose pas 1 Janar 2019).*

Ndryshimet në SNRF 2 “Pagesat bazuar në Aksione”, - Klasifikimi dhe Matja e transaksioneve të pagesave me bazë aksionet *(efektiv më ose pas datës 1 Janar 2018),*

Ndryshimet në SNRF 4 “Kontratat e sigurimit” - Aplikimi i SNRF 9 “Instrumentat financiarë” me SNRF 4 “Kontratat e sigurimit” (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018, ose kur SNRF 9 “Instrumentat financiarë”, është aplikuar për herë të parë)

Amendime në SNRF 15, Të ardhurat nga Kontratat me Klientet *(efektiv për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janar 2018).*

Ndryshimet në SNRF 10 “Pasqyrat Financiare të Konsoliduara” dhe SNK 28 “Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta” - Shitja apo Kontributi i aseteve mes një Investitori dhe bashkëpunëtorëve të tij, ose sipërmarrje të përbashkëta dhe ndryshimeve të mëtejshme (data efektive e shtyrë për kohë të pacaktuar derisa projekti kërkimor mbi metodën e kapitalit neto të jetë përfunduar).

Ndryshimet në SNK 40 “Aktivet Materiale Afatgjata të Investuara” - Transferimet e aktiveve materiale afatgjata të investuara (efektive më ose pas 1 janarit 2018),

Ndryshime në SNRF 1 dhe SNK 28 si pasojë e “Përmirësimeve të SNRF-ve (cikli 2014-2016)” rezultuar nga projekti i përmirësimit vjetor të SNRF (SNRF 1, SNRF 12, dhe SNK 28) kryesisht me një pikëpamje për të eliminuar mospërputhjet dhe për të qartësuar formulimin (ndryshimet mbi SNRF 1 dhe SNK 28 do të jenë të aplikueshme për periudhat vjetore duke filluar në ose pas datës 1 Janar 2018).

Ndryshimet në standardet e ndryshme “Përmirësimet në SNRF-të (cikli 2015-2017)” që rezultojnë nga përmirësimi i përvitshëm të projektit të SNRF (SNRF 3, SNRF 11, SNK 12 dhe SNK 28) kryesisht me qëllimin që të shmangin mospërputhjet dhe të qartësojnë formulimin (efektiv në periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2019),

KIRFN 22 “Transaksionet valutë dhe Konsiderata për avancat” (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018),

KIRFN 23 “Pasiguria mbi Trajtimin e Tatimit mbi të Ardhurat” (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).

Kompania ka zgjedhur të mos miratojë këto standarde të reja dhe ndryshime në standardet ekzistuese përpara datës kur hyjnë në fuqi. Kompania parashikon që adoptimi i këtyre standardeve dhe ndryshimet në standardet ekzistuese nuk do të kenë ndikim material në pasqyrat financiare të Kompanisë.

2. Bazat e përgatitjes (vazhdim)

(c) Bazat e konsolidimit

Filialet janë të gjitha njësitë ekonomike (duke përfshirë njësitë ekonomike për qëllime të veçanta) ndaj të cilave Grupi ka fuqi për të drejtuar politikatat e përgjithshme financiare dhe operacionale çka zakonisht shoqërohet me zotërim të më shumë se gjysmës së aksioneve me të drejtë vote. Ekzistenca dhe ndikimi i të drejtave potenciale të ushtrimit të votës që janë aktualisht të ushtrueshme apo të konvertueshme merren në konsideratë kur vlerësohet kontrolli i grupit ndaj një njësie tjetër ekonomike. Filialet janë plotësisht të konsoliduara prej datës në të cilën kontrolli i transferohet Grupit. Ato nuk përfshihen në konsolidim në momentin që kontrolli ndërpritet.

Për regjistrimin në kontabilitet të blerjes nga Grupi të filialeve është përdorur metoda e blerjes. Kostoja e një blerjeje matet si vlera e drejtë e aktiveve të dhëna, instrumenteve të emetuar të kapitalit dhe detyrimeve të ndodhura ose të marra përsipër në datën e shkëmbimit, plus kostot e lidhura direkt me blerjen. Aktivitetet e blera, detyrimet dhe detyrimet e kushtëzuara të identifikueshme që merren përsipër në një kombinim biznesesh maten fillimisht me vlerën e tyre të drejtë në datën e blerjes, pavarësisht nga shtrirja e çdo interesi të pakicës. Teprica e kostos së blerjes mbi vlerën e drejtë të pjesës së Grupit të aktiveve neto të identifikueshme të blera regjistrohet si emri i mirë. Nëse kostoja e blerjes është më e vogël se vlera e drejtë e aktiveve neto të filialit të blerë, diferenca njihet drejtpërdrejt në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Transaksionet brenda Grupit, balancat dhe fitimet e parealizuar nga transaksionet midis Shoqërive të Grupit, eliminohen. Humbjet e parealizuar gjithashtu eliminohen, por konsiderohen si tregues i rënies në vlerë të aktivitetit të transferuar. Politikatat kontabël të filialeve janë ndryshuar kur është gjykuar e nevojshme për të siguruar qëndrueshmëri me politikatat e adoptuara nga Grupi

(d) Monedha funksionale dhe raportuese

Këto pasqyra financiare të konsoliduara paraqiten në mijë Lekë ('000 LEK), e cila është monedha funksionale dhe raportuese e Grupit. Informacioni financiar i paraqitur në Lekë është përafruar në mijëshen më të afërt, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe.

(e) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të kërkon që drejtimi të kryejë gjykime, çmuarje dhe supozime të cilat ndikojnë në zbatimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të jenë të ndryshme nga këto vlerësime.

Çmuarjet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e çmuarjeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen.

Informacioni mbi elementë të rëndësishëm në vlerësimin e pasigurive dhe mbi gjykimet kritike për zbatimin e politikave kontabël që kanë efekt më të rëndësishëm mbi shumat e regjistruara në pasqyrat financiare jepet në shënimin 5.

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël

Politikatat kontabël paraqitur më poshtë janë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme në të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra të konsoliduara financiare dhe janë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme nga njësitë e Grupit.

(a) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën përkatëse funksionale duke përdorur kurset e këmbimit që mbizotërojnë në datat e transaksioneve. Aktivitetet dhe detyrimet monetare të shprehur në monedha të huaja në datën e raportimit rikonvertohen në monedhën funksionale duke përdorur kurset e këmbimit në atë datë.

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(a) Transaksionet në monedhë të huaj (vazhdim)

Fitimi ose humbja nga ndryshimi i kurseve të këmbimit është diferenca midis kostos së amortizuar në monedhën funksionale në fillim të periudhës të rregulluara me interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj të kthyer në monedhën funksionale me kursin e fundit të periudhës. Aktivët dhe detyrimet jo monetare në monedhë të huaj të cilat maten me vlerë të drejtë, konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së përcaktimit të vlerës së drejtë.

Kurset kryesore të këmbimit ndaj Lekut janë:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
1 EUR	132.95 Lek	135.23 Lek
1 USD	111.10 Lek	128.17 Lek
1 CHF	113.94 Lek	126.05 Lek
100 YEN	98.74 Lek	109.75 Lek

(b) Aktivët afatgjatë materiale

Njohja dhe matja

Aktivët afatgjatë materiale të shoqërisë "KESH" sh.a në pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar janë paraqitur me vlerën e rivlerësuar, që është vlera e drejtë në datën e rivlerësimit së cilës i zbritet zhvlerësimi i akumuluar dhe çdo humbje pasardhëse e akumuluar nga rënia e vlerës.

Rivlerësimet janë kryer me rregullsi të mjaftueshme, të tillë që vlerat kontabël nuk ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme nga ato që do të përcaktoheshin duke përdorur vlerën e drejtë në fund të çdo periudhe raportimi.

Në zbatim të urdhrit Nr.1459 datë 20.02.2015 të Ministrit të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik Turizmit Tregtise e Sipermarjes, si edhe bazuar në kontratën Nr.4699 prot, date 21.05.2015 "Për rivlerësimin e Aktiveve Afatgjatë Materiale të shoqërisë "KESH" sha", dhe në implementim të kërkesave të Standardeve Ndërkombetare të Vlerësimit, në implementim të kërkesave të Standardeve Ndërkombetare të Kontabilitetit (SNK) dhe konkretisht SNK 16 dhe SNK 36.

Rivlerësimi i aktiveve të shoqërisë "KESH" sh.a. është bërë duke u bazuar në keto metoda:

- Metoda e Tregut ose Metoda e Krahimit të Shitjeve
- Kosto e Zëvendësimit e Amortizuar

Metodat e zhvlerësimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi dhe rregullohen nëse është e përshtatshme.

Çdo tepëriç nga rivlerësimi njihet në të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse ('ATGJ') përveç deri në masën që suficient anullon deficitin e mëparshëm të rivlerësimit të të njëjtit aktiv, rast në të cilin kreditimi njihet në fitim ose humbje. Çdo deficit në rivlerësim njihet në fitim ose humbje, përveç në masën që kjo anulon një tepëriç të mëparshme të rivlerësimit të të njëjtit aktiv, rast në të cilin debiti njihet në ATGJ. Prandaj, tepëricat dhe rënië në vlerë nuk mund të netohen edhe brenda të njëjtës klasë aktivesh. Rezerva e rivlerësimit transferohet në fitimet e mbartuara gjatë përdorimit të aktiveve.

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)**(b) Aktivet afatgjata materiale (vazhdim)**

Aktivitet afatgjata materiale të “KESH Security” dhe “TEC Vlorë” paraqiten me kosto historike duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitet. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitet në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitet.

Nëse pjesë të konsiderueshme të një aktivitet afatgjatë material kanë jetë të dobishme të ndryshme, atëherë ato njihen si aktiv i ndarë më vete (komponentë kryesorë) të aktivitet.

Ndërtimet në proces mbahen me kosto, pakësuar me humbjet e njohura nga zhvlerësimi (nese ka) dhe klasifikohen në kategoritë e duhura të aktiveve afatgjata materiale kur përfundohen dhe janë të gatshme për përdorim. Kosto përfshin të gjithë shpenzimet e lidhura drejtpërdrejt me përfundimin e aktivitet. Këto shpenzime përfshijnë tarifën profesionale, ndërsa për aktivet e kualifikuara kostot e huamarrjes kapitalizohen në përputhje me politikat kontabël të Shoqërisë.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar çmimin e shitjes me vlerën kontabël. Këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kostot vijuese

Kosto vijuese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale kapitalizohet nëse pritët që Shoqëria do të ketë përfitime të ardhshme ekonomike nga këto shpenzime.

Zhvlerësimi

Zhvlerësimi llogaritet për të anuluar shumat e rivlerësuar të aktiveve afatgjata materiale duke i zbritur vlerën e mbetur sipas metodës lineare të amortizimit, përgjatë jetës së dobishme dhe njihet në fitim ose humbje.

Jetët e dobishme të aktiveve afatgjata materiale për periudhën aktuale dhe atë krahasuese janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Ndërtesa	8 – 100 vjet	8 – 100 vjet
Makineri dhe pajisje	5 - 65 vjet	5 - 65 vjet
Mjete transporti	5 -15 vjet	5 -15 vjet
Orendi, instalime dhe pajisje	2 - 4 vjet	2 - 4 vjet

Toka, ndërtimet në proces dhe parapagimet ndaj furnitorëve nuk zhvlerësohen.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar çmimin e shitjes me vlerën kontabël. Këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Shoqëria zbaton Standartet Nderkombetare të Kontabilitetit dhe Standartet Nderkombetare të Raportimit Financiare (SNK) dhe (SNRF) sipas të cileve kërkohej rivlerësimi i aktiveve afatgjata materiale (AAM) e jo materiale (AAJM) për matjen pas njohjes fillestare.

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(c) Aktivet jomateriale

- *Shpenzimet e kërimit dhe zhvillimit*

Shpenzimet e kryera për zhvillimin e projekteve (Aktivet afatgjata jo-materiale) të blera nga Shoqëria janë paraqitur me kosto të pakësuar me amortizimin dhe humbjet e akumuluar të rënies në vlerë (SNK 38), duke konsideruar mundësinë komerciale dhe teknologjike, ku edhe kostot mund të maten në mënyrë të besueshme. Shpenzimet vijuese të aktiveve afatgjata të patrupëzuara kapitalizohen vetëm kur rrisin përfitimet e ardhshme ekonomike nga aktivet specifike me të cilat lidhen. Të gjitha shpenzimet e tjera shpenzohen në momentin që ndodhin.

Amortizimi njihet në fitim ose humbje me metodën lineare përgjatë jetëgjatësisë së parashikuar të aktiveve afatgjata jo-materiale. Jetëgjatësia e parashikuar është 5 vite.

(d) Rënia në vlerë e aktiveve jo-financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Grupit, përveç inventarit dhe tatimit të shtyrë aktiv rishikohen në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka ndonjë tregues për rënie në vlerë. Nëse një tregues i tillë ekziston atëherë matet vlera e rikuperueshme e aktivit. Një humbje nga rënia në vlerë njihet nëse vlera kontabël është më e madhe sesa vlera e rikuperueshme. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Shuma e rikuperueshme e një aktivi është vlera më e madhe mes vlerës në përdorim dhe vlerës së tregut minus kostot e shitjes. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e ardhshme monetare skontohej me një normë skontimi para tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut të vlerës në kohë të parasë dhe rreziqet specifike që lidhen me aktivin.

Humbjet nga rënia në vlerë të njohura në periudha të mëparshme vlerësohen në çdo datë raportimi për ndonjë tregues rreth zvogëlimit ose eliminimit të humbjes. Një humbje nga rënia në vlerë rikthehet nëse ka pasur një ndryshim në treguesit e përdorur për të përcaktuar vlerën e rikuperueshme. Një humbje nga rënia në vlerë rimerret vetëm në masën në të cilën vlera kontabël e aktivit nuk e kalon vlerën e aktivit që duhej të përcaktohej, neto nga amortizimi dhe zhvlerësimi, nëse asnjë humbje nga rënia në vlerë nuk do të ishte njohur.

(e) Rënia në vlerë e aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet që ka pësuar një rënie në vlerë nëse ka evidencë objektive që tregon se një ose disa ngjarje kanë pasur efekt negative mbi flukset e ardhshme monetare të këtij aktivi.

Një humbje nga rënia në vlerë në lidhje me një aktiv financiar matur me kosto të amortizuar llogaritet si diferencë mes vlerës së tij kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të ardhshme të skontuara me normën origjinale efektive të interesit.

Aktivitet financiar të rëndësishme individualisht testohen për rënie në vlerë mbi baza individuale. Aktivitet financiar të mbetura vlerësohen në grupe që ndajnë karakteristika të ngjashme në lidhje me rreziqet kredituese. Të gjitha humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga rënia në vlerë rimerret nëse rimarrja mund të lidhet në mënyrë objektive me një ngjarje që ndodh pasi humbja është njohur. Për aktivitet financiar të matura me kosto të amortizuar rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

(f) Inventarët

Inventarët maten me shumën më të vogël midis kostos dhe vlerës së realizueshme neto. Kostoja e inventarëve bazohet në parimin hyrje e parë, dalje e parë (FIFO) dhe përfshin shpenzime të ndodhura në blerjen e inventarëve, kostot e prodhimit dhe të transformimit dhe kosto të tjera të ndodhura gjatë transferimit të tyre në vendodhjen dhe konditat ekzistuese. Në rastin e inventarëve të prodhuar dhe punimeve në proces, kostoja përfshin një shpërndarje të caktuar të shpenzimeve të përgjithshme të prodhimit duke u bazuar në kapacitetin normal të aktivitetit.

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(f) Inventarët (vazhdim)

Kostoja e inventarit mund të përfshijë edhe transferime nga kapitali të çdo fitimi apo humbjeje nga mbrojtje të kualifikueshme të flukseve monetare nga blerjet në monedhë të huaj të inventarit. Vlera e realizueshme neto është çmimi i vlerësuar i shitjes në rrjedhën normale të biznesit duke zbritur shpenzimet e vlerësuara të përfundimit të shitjes.

(g) Instrumentat financiarë

Grupi zotëron vetëm instrumenta financiarë jo-derivativë, duke përfshirë llogari të arkëtueshme, mjete monetare, huamarrje dhe huadhënie, dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat jo me vlerë të drejtë kostot e transaksionit kalojnë në shpenzime dhe të ardhura. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Grupi bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivët financiarë çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të Grupit ndaj flukseve të parasë së aktivitetit financiar ose kur kompania transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontroll ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit.

Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën Grupi angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të Grupit skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Paraja dhe mjetet monetare ekuivalente me to

Paraja dhe ekuivalentët e parasë (mjetet monetare) përfshijnë arkën, depozitat në para me bankat, investime të tjera tejet likuide me maturim fillestar prej tre ose më pak muajsh.

Llogaritë e arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi.

Llogaritë e pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar

Huadhënie dhe huamarrje

Huate e Dhena : Huate e arkëtueshme janë aktive financiare jo-derivative me pagesa të percaktuara sipas kushteve kontraktuale me pagesa fikse dhe variabël në varesi të normave të interesit të cilat nuk janë të kuotuar.

Pas matjes fillestare, të tilla aktive financiare maten në vazhdim me kosto të amortizuar.

Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Huate e marra : Huate (detyrime financiare), janë njohur fillimisht me vlerën e tregut plus kostot e transaksioneve dhe më pas njihen me koston e amortizuar.

Shpenzimet duke u bazuar në interesin efektiv të llogaritur me vlerën e drejtë pasqyrohen në pasqyrën e të Ardhurave dhe Shpenzimeve.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Vlera e drejtë e llogarive të arkëtueshme, duke përjashtuar ndërtimet në proces, vlerësohet si vlera aktuale e flukseve të ardhshme të parasë, të skontuara me normën e interesit në treg në datën e raportimit.

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(g) Instrumentat financiarë (vazhdim)

Instrumentat financiarë janë klasifikuar si detyrime afat-shkurtra përveç rastit kur Grupi ka një të drejtë të pakushtëzuar për shtyrjen e shlyrjes së detyrimit për të paktën 12 muaj pas datës së bilancit.

(h) Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë me banka dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen kur maturohen duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

(i) Kapitali aksionar

Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapital. Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale.

(j) Tatimi mbi fitimin dhe tatimi i shtyrë

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin për periudhën dhe atë të shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet drejtpërdrejt në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen drejtpërdrejt në kapital, në këtë rast tatimi njihet në kapital.

Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm për t'u paguar mbi të ardhurat e tatueshme të vitit, duke përdorur normat tatimore të miratuara në datën e raportimit, dhe çdo rregullim të tatimit të pagueshëm nga vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyrë njihet duke përdorur metodën e bilancit, duke marrë në konsideratë diferencat e përkohshme midis vlerës së mbetur të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe shumat e përdorura për qëllime tatimore. Tatimi i shtyrë llogaritet me normat tatimore që aplikohen ndaj diferencave të përkohshme kur ato rimerren, bazuar në legjislacionin e miratuar në datën e raportimit.

Një aktiv tatimor i shtyrë njihet deri në masën që është e mundshme që të ekzistojnë përfitime të ardhshme tatimore të vlefshme që diferencat e përkohshme mund të përdoren kundrejt tyre. Aktivet tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe reduktohen në masën që nuk është më e mundshme që përfitimi tatimor në lidhje me to të realizohet.

(k) Përfitimet e punonjësve

- *Fondet e sigurimeve shoqërore, pensionale dhe të shëndetit*

Sipas legjislacionit shqiptar në fuqi Grupi është i detyruar të kryejë kontribute fikse për llogari të punonjësve në një fond të administruar nga qeveria. Të gjitha këto pagesa/detyrime njihen si shpenzim në periudhën të cilës i përkasin.

- *Përfitimet në përfundim të marrëdhënieve të punës*

Sipas kontratës kolektive të punës, në rast të përfundimit të kontratës së punësimit pasi punonjësi ka arritur moshën e kërkuar me ligj për daljen në pension, pavarësisht nga arsyeja e përfundimit, punonjësi ka të drejtën e një kompensimi prej 2 pagash mujore bruto.

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(k) Përfitimet e punonjësve

Përfitimet në përfundimin e kontratës njihen si shpenzim kur Grupi është i përkushtuar pa ndonjë mundësi realiste të rreheqje ndaj një plani formal dhe të detajuar që të përfundojë kontratën përpara datës normale të daljes në pension ose të sigurojë përfitimet e përfundimit si rezultat i një oferte për të përkrahur sigurimin vullnetar. Përfitimet në përfundimin e kontratës për sigurimet vullnetare njihen si një shpenzim nëse Grupi ka bërë një ofertë për sigurimin vullnetar dhe është e mundshme që oferta do pranohet dhe numri i pranimeve mund të matet në mënyrë të besueshme.

(l) Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Grupi ka një detyrim të tërthortë ligjor i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkohej flukse dalëse parash për shlyerjen e këtij detyrimi. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet specifike të detyrimit.

(m) Njohja e të ardhurave

Të ardhurat janë flukset hyrëse bruto të përfitimeve ekonomike lindur në rrjedhën normale të aktiviteteve të Grupit që rezultojnë në rritje të kapitalit gjatë periudhës dhe nuk përfshijnë rritjet e kapitalit në tij të kontributeve të aksionerëve në kapital. Të ardhurat përfshijnë vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar apo të arkëtueshme nga shitja e të mirave dhe shërbimeve në rrjedhën normale të aktiviteteve të Grupit.

Të ardhurat nuk përfshijnë tatimin e vlerës së shtuar, kthimet, rabatet dhe zbritjet. Kur shumata e të ardhurave mund të matet me besueshmëri, Grupi i njeh të ardhurat duke u bazuar në faturat e lëshuara për furnizimin me energji. Shumata e të ardhurave nuk konsiderohet si e matshme me besueshmëri derisa nuk janë zgjidhur të gjithë kushtëzimet në lidhje me shitjen. Grupi bazohet në rezultatet historike, duke mbajtur parasysh llojin e klientit, tipin e transaksionit dhe specifikimet e çdo marrëveshjeje, për të kryer vlerësimet e veta.

Shitja e energjisë

Të ardhurat nga shitja e energjisë elektrike është njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve bazuar në sasinë aktuale të energjisë elektrike të shitur për (i) FPP (OSHEE sh.a.); (ii) brenda dhe jashtë vendit me çmime të parregulluara; (iii) energji për mbulimin e humbjeve të OST sh.a.; (iv) energji për disbalancat.

(n) Qiratë

Qiratë në të cilat një pjesë e rëndësishme e rreziqeve dhe përfitimeve të pronësisë mbahen nga qiramarrësi klasifikohen si të qira operative. Pagesat e qirave të zakonshme (duke përjashtuar stimuluesit e vendosur nga qiramarrësi) njihen me metodën lineare në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përgjatë periudhës së qirasë. Shpenzimet për kestat minimale të qirase llogariten dhe evidentohen në përpjestim me kohën e maturimit të qirase, përgjate afatit të qirase, pavarësisht nga koha dhe shumata e paguar në fakt.

(o) Shpërndarja e dividendit

Shpërndarja e dividendëve për aksionerët e Shoqërisë njihet në pasqyrat financiare të Grupit si detyrim i periudhës në të cilën janë aprovuar nga aksionerët e Shoqërisë.

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)**(p) Grantet qeveritare**

Grantet qeveritare njihen fillimisht si të ardhura të shtyra kur ka një siguri të arsyeshme se grantet qeveritare do të merren dhe Grupi do të jetë në përputhje me konditat që i janë bashkëngjitur grantit. Grantet që kompensojnë shpenzimet e ndodhura të Grupit, njihen në mënyrë sistematike në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në të njëjtën periudhë në të cilën kanë ndodhur shpenzimet. Grantet që kompensojnë koston e aktiveve të Grupit, njihen në mënyrë sistematike në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përgjatë jetës së dobishme të aktivit.

4. Menaxhimi i rrezikut financiar

Funksioni i menaxhimit të rrezikut brenda Grupit është realizuar për rreziqet financiare (kredia, tregu, monedha, likuiditeti dhe norma e interesit), rrezikun operacional (siç është rreziku mjedisor) dhe rrezikun ligjor. Objektivat kryesore të funksionit të menaxhimit të rrezikut janë përcaktimi i kufijve të rrezikut dhe sigurimi që ekspozimi ndaj rreziqeve të qëndrojë brenda këtyre kufijve. Funksionet e menaxhimit të rrezikut operacional dhe atij ligjor kanë për qëllim të sigurojnë funksionimin e duhur të politikave dhe procedurave të brendshme për të minimizuar këto rreziqe.

Zhvillimet aktuale

Drejtimi i Grupit kryen monitorim të rregullt mbi të gjitha pozicionet e aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe mbi zhvillimin e tregjeve financiare ndërkombëtare. Bazuar në këto, menaxhimi analizon përfitueshmërinë, likuiditetin dhe koston e fondeve si dhe kërkon të implementojë masa të përshtatshme në lidhje me kredinë, tregun (kryesisht normat e interesit), dhe riskun e likuiditetit, duke kufizuar kështu efektet e mundshme negative nga kriza globale financiare dhe ekonomike. Në këtë mënyrë, duke mbajtur një pozicion kapital dhe likuid të qëndrueshëm Grupi i përgjigjet sfidave të tregut.

4.1 Rreziku i kredisë

Grupi është i ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë i cili është rreziku që një palë në një instrument financiar të shkaktojë një humbje financiare ndaj palës tjetër duke dështuar në shlyerjen e një detyrimi. Ekspozimi kryesor i Grupit ndaj rrezikut të kredisë vjen si pasojë e llogarive të arkëtueshme e të tjera Kreditë e marra nga Grupi financojnë projekte që do të rezultojnë në aktive që do të materializohen ose janë materializuar në KESH, OST, ose OSHEE dhe në një rast të tillë marrveshja kryesore e kredisë në të cilën Grupi dhe njësisia financuese kanë hyrë është ndarë me tej në nën-marrveshje kredie midis Grupit dhe OST ose OSHEE.

Ekspozimi maksimal i Grupit ndaj rrezikut të kredisë sipas kategorisë së instrumentit financiar dhe sipas kategorisë së aktiveve para kolateralit dhe përmirësimeve të tjera të kredisë është si vijon:

<i>Në mijë Lek</i>	2017	2016
<i>Hua dhe llogari të arkëtueshme</i>		
Mjete monetare në bankë	796,783	805.336
Llogari të arkëtueshme		
- Shoqëri private	50,595,521	51.463.006
- Njësi të kontrolluara nga shteti	369	369
Hua dhe llogari të arkëtueshme	20,038,456	21.009.236
Llogari të arkëtueshme nga punonjësit	37,861	39.049
TVSH		
Të tjera	2,109,595	2.049.338
Ekspozimi total ndaj rrezikut të kredisë	73,578,586	75.366.334

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)**4.1 Rreziku i kredisë (vazhdim)****4.1.1 Menaxhimi i rrezikut të kredisë**

Grupi është i ekspozuar ndaj rreziqeve të kredisë sepse është e mundur që klientët ose huamarrësit të dështojnë të shlyejnë detyrimet e tyre financiare. Për më tepër, rreziku i kredisë që lidhet me marrëveshjet e kredisë të Grupit menaxhohet dhe monitorohet mbi bazën e nën-marrëveshjeve të mëtejshme të kredisë mes Grupit dhe përfituesve të projekteve të huaja të financimit. Këto marrëveshje përfshijnë kushte dhe angazhime të cilat ndihmojnë Grupin në monitorimin dhe minimizimin e rrezikut të kredisë. Këto angazhime analizohen dhe monitorohen rregullisht siç kërkohet nga marrëveshja origjinale e kredisë.

4.1.2 Përqendrimi i rrezikut të kredisë

Grupi është i ekspozuar ndaj përqendrimit të rrezikut të kredisë. Drejtuesit monitorojnë përqendrimin e rrezikut të kredisë, por ndeshin vështirësi në zbatimin e praktikës më të mirë të politikave të menaxhimit mbi ekspozimin e Grupit ndaj këtij rreziku përmes diversifikimit të portofolit të kredisë. Kjo për shkak se shoqëria ushtron funksionin e prodhuesit për shërbim publik për ti garantuar Furnizuesit të Shërbimit Universal sasinë e energjisë elektrike që do të prodhohet nga njësitë gjeneruese mbi kaskadën e lumit Drin (HEC Fierzë, HEC Koman dhe HEC Vau Dejës) bazuar në regjimin racional të shfrytëzimit të kapaciteteve gjeneruese dhe nivelin historik mesatar shumëvjeçar dhe që do të shkojë për mbulimin e kërkesës për energji elektrike të konsumatorëve fundorë që përfitojnë nga Furnizimi i Shërbimit Universal. Në këto rrethana, masat për diversifikim janë të vështira për t'u zbatuar.

4.2 Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku i humbjes si rezultat i ndryshimeve në çmimet e tregut (çmimet e mallrave të energjisë), kurset e këmbimit, normat e interesit dhe çmimet e kapitalit. Niveli i rrezikut të tregut ndaj të cilit Grupi është i ekspozuar ndryshon në varësi të kushteve të tregut, pritshmërive për ndryshime të ardhshme të çmimeve ose normave të tregut dhe përbërjes së aktiveve fizike dhe portofolit të kontratave të Grupit.

4.2.1 Rreziku i kursit të këmbimit

Rreziku i kursit të këmbimit vjen nga fakti se të ardhurat e Grupit dhe shumica e huave dhe llogarive të arkëtueshme janë të shprehura në Lekë, ndërkohë që një pjesë e madhe e kredive të grupit janë të shprehura në monedha të huaja (kryesisht Euro, Yen Japonez dhe Dollarë Amerikan). Rreziku është që vlera e monedhës së flukseve të parasë nga shlyerja e kredive dhe interesit përkatës, si dhe nga pagesa e faturave për energjinë e importuar, do të ndryshojë si rezultat i lëvizjeve në kurset e këmbimit të cilat mund të kenë një ndikim të konsiderueshëm në fitimin e Grupit.

Tabela e mëposhtme përmbledh ekspozimin e grupit ndaj rrezikut të kursit të këmbimit të monedhave të huaja në datën e bilancit:

Në mijë Lek	Më 31 Dhjetor 2017			Më 31 Dhjetor 2016		
	Aktive financiare monetare	Detyrime financiare monetare	Pozicioni neto i bilancit	Aktive financiare monetare	Detyrime financiare monetare	Pozicioni neto i bilancit
LEK	52,196,788	(45,072,810)	7,123,978	32.601.746	(49.874.094)	(17.272.348)
EUR	12,666,702	(35,753,074)	(23,086,372)	33.381.887	(29.550.803)	3.831.084
USD	1,556,325	(5,797,528)	(4,241,203)	1.780.257	(6.507.055)	(4.726.798)
YEN	2,657,167	(2,766,116)	(108,949)	3.004.531	(3.065.301)	(60.770)
CHF	957,780	(2,585,535)	(1,627,755)	1.059.578	(2.956.750)	(1.897.172)
Të tjera	3,543,824	(2,565,632)	978,192	3.538.335	(2.477.392)	1.060.943
Totali	73,578,586	(94,540,695)	(20,962,109)	75,366.334	(94.431.395)	(19.065.061)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)**4.1 Rreziku i kredisë (vazhdim)****4.2.1 Rreziku i kursit të këmbimit (vazhdim)**

Analiza e mësipërme përfshin vetëm aktivet dhe detyrimet monetare. Investimet në kapital dhe aktive jo-monetare nuk konsiderohet të sjellin ndonjë rrezik material të kursit të këmbimit.

Me qëllimin për të optimizuar koston e financimit, në disa raste, Grupi ka marrë kredi në monedhë të huaj, kryesisht në Dollarë Amerikan, Euro dhe Yen Japonez.

4.2.2 Rreziku i normës së interesit

Grupi merr hua në rrjedhën normale të biznesit për financimin e veprimtarisë së tij. Grupi është i ekspozuar ndaj rrezikut të normës së interesit sepse vlera e drejtë e kredive me normë fikse si dhe flukset e parasë prej kredive me normë të ndryshueshme do të luhet sipas luhatjeve në normat e interesit.

Tabela e mëposhtme përmbledh ekspozimin e Grupit ndaj rreziqeve të normës së interesit. Tabela paraqet shumat e totale të aktiveve dhe detyrimeve financiare të Grupit të kategorizuara sipas datës më të hershme midis datës së rrimimit të interesit kontraktual dhe datës së maturimit.

<i>Në mijë Lekë</i>	Nga 1 deri në 12 muaj	Nga 1 deri në 5 vjet	Më shumë se 5 vjet	Totali
31 Dhjetor 2017				
Totali i aktiveve financiare monetare	60,888,507	3,475,045	9,215,033	73,578,585
Totali i detyrimeve financiare monetare	(65,198,041)	(13,199,487)	(16,143,166)	(94,540,694)
Hendeku i ndjeshmërisë ndaj interesit më 31 Dhjetor 2017	(4,309,534)	(9,724,442)	(6,928,133)	(20,962,109)
31 Dhjetor 2016				
Totali i aktiveve financiare monetare	60.488.526	4.645.024	10.232.783	75.366.333
Totali i detyrimeve financiare monetare	(63.139.996)	(15.102.401)	(16.188.997)	(94.431.394)
Hendeku i ndjeshmërisë ndaj interesit më 31 Dhjetor 2016	(2.651.470)	(10.457.377)	(5.956.214)	(19.065.061)

4.2.3 Rreziqe të tjera të çmimeve**4.2.3.1 Çmimet e instrumenteve të kapitalit**

Grupi nuk ka ekspozim ndaj rrezikut të çmimit të instrumenteve të kapitalit pasi nuk mban aktive financiare që të përfshijnë instrumente të kapitalit në datën e bilancit. Nuk është politikë e Grupit të blejë instrumente të tillë dhe të ekspozohet ndaj rrezikut të çmimit lidhur me lëvizjet në indekset e tregut të kapitalit.

4.2.3.2 Çmimet e energjisë

Për periudhën Janar -Dhjetor 2017, Bordi i ERE nëpërmjet, vendimit Nr.190, datë 22.12.2016 që la në fuqi vendimin Nr. 139, datë 26.12.2014 (respektivisht, tarifën e shitjes së energjisë elektrike nga KESH sh.a tek OSHEE sh.a (1.45 lekë/kWh) dhe së fundmi vendimit Nr.194, datë 30.12.2016 i cili la në fuqi tarifën 1.45 lekë/kWh për shitjen e energjisë elektrike tek OST sh.a për mbulimin e humbjeve në sistemin e transmetimit dhe tarifën 158 lekë/MW/h për shërbimet ndihmëse.

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

4.2 Rreziku i tregut (vazhdim)

4.2.3 3 Rreziqe të tjera të çmimeve

Më pas Bordi i ERE me vendimin Nr.52, datë 06.04.2017 vendosi shtyrjen deri në 31.12.2017 të fuqisë juridike të vendimit Nr. 190, datë 22.12.2016 dhe nga ku për pasojë:

- i. Tarifa e shitjes së energjisë elektrike nga KESH sh.a tek OSHEE sh.a/FSHU dhe OST sh.a/OST (energji për mbulimin e humbjeve) për vitin 2017 është 1.45 Lek/kWh.
- ii. Tarifa për shërbimet ndihmëse për vitin 2017 është 158 lekë/MW/h.

Gjithashtu me vendimin e Bordit të ERE Nr.62, datë 11.05.2017 u miratua kontrata për shitblerje të energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë KESH sh.a dhe OSHEE sh.a/FSHU.

Në pjesën arsyetuese të vendimit për miratimin e kontratës në fjalë përcaktohej se regjimi racional i shfrytëzimit të kapaciteteve gjeneruese, si dhe niveli historik mesatar vjetor për një periudhë 25 vjeçare (1991-2016) të prodhimit të KESH sh.a prej kaskadës së lumit Drin është rreth 4.200.000 GWh nga ku për qëllime të përmbushjes së detyrimit për shërbim publik shoqëria KESH sh.a do të programojë të furnizojë:

- iii. OSHEE sh.a/FSHU për sasinë vjetore prej 3.950 GWh;
- iv. OST sh.a/OST për sasinë vjetore prej 161 GWh për mbulimin e humbjeve dhe nevojave vetjake në sistemin e transmetimit; si edhe
- v. Sasinë mesatare prej 89 GWh energji për shërbimet ndihmëse dhe të balancimit.

Çdo sasi e tepërt e energjisë elektrike e krijuar përtej sasisë së nevojshme të energjisë elektrike të furnizuar për OSHEE sh.a/FSHU do të shkojë fillimisht për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes (me çmim HUPX) dhe nëse sërish ka teprica energjie elektrike përtej nevojës për energji elektrike nga OSHEE sh.a/FSHU/OSSH, ato do të tregtohet nga KESH sh.a në tregun e parregulluar (me çmime tregu).

Me miratimin e ndryshimeve në VKM Nr.244/2016 (ndryshuar me VKM Nr.483/2017 dhe 729/2017) KESH sh.a për shkak të kushteve hidrike të pafavorshme për vitin 2017, u detyrua të përdorë huan e dhënë nga BERZH (EBRD) duke importuar energji elektrike për mbulimin e pjesshëm të kërkesës për energji elektrike të OSHEE/FSHU.

Për të menaxhuar rrezikun, shoqëria optimizon aktivet e saj dhe portofolin e kontratave nëpërmjet një metode bazuar në analiza të hollësishme të pozicionit të ofertës dhe kërkesës dhe në vlerësime të vazhdueshme të tregjeve lokale në të cilat ajo operon. Politika nuk nënkupton mbrojtjen e një pjese të ekspozimit.

Grupi është i ekspozuar ndaj rrezikut të çmimeve të energjisë nga ku rreziku vjen kryesisht për faktin se paqëndrueshmëria klimaterike (mungesa e reshjeve siç rezultoi në vitin 2017) ndikon në sasinë e prodhuar të energjisë elektrike duke detyruar KESH sh.a të kompensojë financiarisht OSHEE sh.a /FSHU për sasinë e programuar dhe të pa livruar të energjisë elektrike në kuadër të detyrimit për shërbim publik referuar kjo parashikimeve të nenit 5 të VKM Nr.244/2016 dhe vendimeve të Bordit të ERE Nr.112/2016 dhe Nr.62/2016.

Paqëndrueshmëria klimaterike dhe njëkohësisht risku hidrologjik që mbart aktiviteti i shoqërisë KESH sh.a veçanërisht me pasigurinë e regjimeve të ardhshme të prodhimit dhe mundësisë për tregtimin e energjisë elektrike në rastin e tepricave, vështirësojnë llogaritjen e parashikimeve të besueshme për të mbështetur vendimet për investime duke çuar në kthyeshmëri potenciale më të vogël se ajo e pritshme.

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)**4.3 Rreziku i likuiditetit**

Rreziku i likuiditetit përcaktohet si rreziku që njësia të ndeshë vështirësi në shlyerjen e detyrimeve të saj financiare. Grupi është i ekspozuar ndaj kërkesave ditore për përdorim të burimeve të veta të parasë kryesisht për të paguar shpenzimet operative të ndeshura në aktivitetin e saj të zakonshëm dhe për të shlyer kreditë. Rreziku i likuiditetit menaxhohet nga drejtuesit e Grupit. Drejtuesit monitorojnë çdo ditë, javë dhe muaj parashikimet periodike të flukseve të parasë së Grupit.

Grupi gjatë vitit 2017 ka hartuar një plan për ristrukturimin e linjavë të overdrafteve me qëllim menaxhimin sa më të mirë të riskut të likuiditetit.

Procesi i adoptuar nga drejtuesit për menaxhimin e likuiditetit përfshin edhe vendosjen e kufizimeve ndaj degëve për shpenzimet në lidhje me aktivitetet e përditshme si shërbimet, furnizimet si dhe për investimet, shtyrjen e pagesave ndaj disa kreditorëve ose riskedulimin e marrëveshjeve midis palëve dhe parashikimin e pagesave të kredive duke siguruar që këto të jenë të mbuluara etj.

Tabela që vijon tregon detyrimet sipas maturimit të tyre të kontraktuar. Shumat e paraqitura në tabelën e maturimit janë flukse kontraktuale të paskontuara të parasë, duke përfshirë pagesat e kredive.

Kur shuma e pagueshme nuk është fikse, shuma që paraqitet është përcaktuar duke iu referuar kushteve që kanë ekzistuar në datën e raportimit. Pagesat në monedhë të huaj janë konvertuar me kursin ditor të këmbimit në datën e bilancit.

Analiza e vjetërsisë së detyrimeve financiare më 31 Dhjetor 2017 është si vijon:

Detyrimet më 31 Dhjetor 2017	Nga 1 deri në 12 muaj	Nga 12 muaj në 5 vjet	Më shumë se 5 vjet	Totali
Llogari të pagueshme e të tjera	13,785,556			13,785,556
Kredi dhe hua	51,412,485	13,199,487	15,333,019	79,944,991
Detyrime të tjera afat-gjata			810,147	810,147
Totali i pagesave të ardhshme	65,198,041	13,199,487	16,143,166	94,540,694

Detyrimet më 31 Dhjetor 2016	Nga 1 deri në 12 muaj	Nga 12 muaj në 5 vjet	Më shumë se 5 vjet	Totali
Llogari të pagueshme e të tjera	18.033.501			18.033.501
Kredi dhe hua	45.106.494	15.102.401	15.378.850	75.587.746
Detyrime të tjera afat-gjata			810.147	810.147
Totali i pagesave të ardhshme	63.139.996	15.102.401	16.188.997	94.431.394

4.4 Vlerat e drejta

Vlera e drejtë është shuma për të cilën mund të shkëmbehet një instrument financiar në një transaksion të zakonshëm mes palëve të mirëinformuara, e që nuk përbën një shitje të detyruar ose likuidim, dhe përfaqësohet më së miri nga një çmim i vlerësuar në një treg aktiv.

4.4.1 Aktivët financiarë të mbajtura me kosto të amortizuar

Vlera e drejtë e huave dhe llogarive të arkëtueshme supozohet se është e përafërt me vlerën e tyre kontabël duke qenë se ato janë instrumente afat-shkurtër që nuk mbartin interes.

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

4.4 Vlerat e drejta (vazhdim)

4.4.2 Detyrime të mbajtura me kosto të amortizuar

Vlera e drejtë e detyrimeve të ripagueshme në të parë supozohet se është shumë e përafërt me vlerën kontabël. Shumat e ardhshme të pagueshme skontoen me norma që variojnë nga 2,58% në vit në 5,21% në vit (2016: nga 2.6% në vit në 4.79% në vit), në varësi të maturimit dhe monedhës në të cilën është shprehur detyrimi. Vlerat kontabël të llogarive të pagueshme e të tjera janë të përafërta me vlerat e tyre të drejta.

4.5 Menaxhimi i kapitalit

Objektivat e Grupit në menaxhimin e kapitalit janë të ruajë aftësinë e Grupit për vijimësi të biznesit me qëllim të mundësimin të kthyeshmërisë për aksionarët dhe të përfitimeve për grupe të tjera të interesit dhe për të mbajtur një strukturë optimale të kapitalit për të reduktuar koston e kapitalit. Grupi mund të përcaktojë shumën e dividendëve të paguar, kthyeshmërinë e kapitalit ndaj aksionarëve, të emetojë aksione të reja apo të shesë aktive për të reduktuar huamarrjen me qëllim që të ruajë apo për të ndryshuar strukturën e kapitalit.

Ashtu si ndodh në industri të tjera, Grupi monitoron kapitalin në bazë të raportit të borxhit. Ky raport llogaritet si total i detyrimeve përmbi totalin e kapitalit nën administrim. Grupi vlerëson se totali i kapitalit nën administrim është i barabartë me kapitalin siç tregohet në bilancin kontabël të konsoliduar. Grupi nuk ka kërkesa nga legjislacioni vendas në lidhje me kapitalin.

5. Vlerësime dhe gjykime të rëndësishme kontabël

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe janë të bazuara në eksperiencën e kaluar dhe në faktorë të tjerë, që përfshijnë ngjarje që priten të ndodhin në të ardhmen. Këto vlerësime dhe gjykime mendohet të jenë të arsyeshme në rrethanat e dhëna.

Grupi bën vlerësime dhe supozime që lidhen me të ardhmen. Këto vlerësime kontabël, teorikisht, rrallë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë një rrezik të konsiderueshëm për të shkaktuar një korrigjim material të vlerave kontabël të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar paraqiten më poshtë.

(a) Vlera e drejtë e instrumenteve financiarë

Vlera e drejtë e instrumenteve financiarë të cilët nuk janë tregtuar në një treg aktiv (p.sh. huatë ndaj punonjësve dhe kreditë) përcaktohet duke përdorur teknikat e vlerësimit. Grupi përdor gjykimin e tij për të zgjedhur një shumëllojshmëri metodash dhe për të bërë supozime të cilat bazohen kryesisht në kushtet ekzistuese të tregut në çdo datë bilanci. Për aktivet dhe detyrimet financiare që nuk tregtohen në tregje aktive, Grupi përdor analizën e skontimit e flukseve të parasë.

(b) Aktive të qëndrueshme të trupëzuara

Drejtuesit e Grupit përcaktojnë jetëgjatësinë e pritshme dhe normat e zhvlerësimit, lidhur me aktivet e qëndrueshme të zotëruara. Ky vlerësim bazohet në ciklin e projektuar të jetës së aktivit. Ai mund të ndryshojë në mënyrë të konsiderueshme si rezultat i ndryshimeve në mjedisin e tregut. Këto ndryshime në jetën e aktiveve, mund të çojnë në rregullime të rëndësishme të vlerës së tyre kontabël neto.

(c) Rënia në vlerë e aktiveve financiare (huave dhe llogarive të arkëtueshme)

Grupi bazohet në udhëzimet e SNK 39 për të përcaktuar se kur një aktiv financiar është i rënë në vlerë. Ky përcaktim kërkon një gjykim të rëndësishëm. Për të gjykuar mbi të, Grupi vlerëson, midis faktorëve të tjerë, kohëzgjatjen dhe nivelin në të cilin vlera e drejtë e një investimi është më e vogël se kosto e tij dhe flukset operative dhe financiare të parasë.

Shuma e rënies në vlerë dhe llogaritë përkatëse të arkëtueshme paraqiten në shënimin 7. Rishqyrtimi i rënies në vlerë të llogarive të arkëtueshme në vitet e ardhshme mund të çojë në korrigjime të rëndësishme të vlerës së tyre kontabël.

KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE – KESH SH.A.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur 31 Dhjetor 2017

(Shumat janë të shprehura në mijë Lek)

6. Aktive afatgjata materiale

(Shumat janë të shprehura në mijë Lek)

	Toka	Ndërtesa	Makineri dhe pajisje	Mjete transporti	Orendi, instalime dhe pajisje	Ndërtime në proces dhe paradhënie ndaj furnitorëve	Totali
Vlera bruto 01.01.2016	1,338,184	87,671,479	48,243,938	232,304	131,124	4,740,209	142,357,238
Shtesa blerje te reja	-	51,281	520,354	42,900	51,358	2,386,747	3,052,641
Shtesa kontribut ne kapital	-	-	-	-	-	-	-
Shtesa te tjera	-	391,983	1,311,327	123,574	25,904	8,008	1,860,795
Nxjerrje jashte perdorimit	-	-	(19,214)	(0)	-	-	(19,214)
Nxjerrje jashte bilanci e aseteve	-	-	-	-	-	-	-
Transferime	-	-	51,331	-	-	(334)	50,997
Pakesime te tjera	-	-	(767,018)	(98,858)	(15,067)	(979,853)	(1,860,795)
31 Dhjetor 2016	1,338,184	88,114,743	49,340,719	299,920	193,320	6,154,776	145,441,662
Shtesa blerje te reja	-	595	305,030	16,656	130,387	4,097,086	4,549,755
Shtesa kontribut ne kapital	-	-	-	-	-	-	-
Shtesa te tjera	56,653	1,549,200	1,809,060	110,790	63,609	5,711	3,595,024
Nxjerrje jashte perdorimit	-	-	-	-	-	-	-
Nxjerrje jashte bilanci e aseteve	-	-	-	(5,563)	-	-	(5,563)
Transferime	-	-	12,385	-	-	(239,982)	(227,597)
Pakesime te tjera	-	(118)	(1,358,667)	(51,464)	(29,834)	(2,154,941)	(3,595,024)
31 Dhjetor 2017	1,394,837	89,664,420	50,108,528	370,339	357,482	7,862,651	149,758,257
Zhvlerësimi i akumuluar							
01.01.2016	-	(30,395,977)	(18,005,244)	(34,911)	(30,853)	-	(48,466,985)
Amortizimi i vitit	-	(1,012,414)	(1,344,811)	(49,183)	(39,718)	-	(2,446,125)
Shtesa kontribut ne kapital	-	-	-	-	-	-	-
Shtesa te tjera	-	-	(156)	(6,947)	(1,464)	-	(8,567)
Nxjerrje jashte bilanci e aseteve	-	-	-	-	-	-	-
Nxjerrje jashte perdorimit	-	-	15,222	60	43	-	15,326
Transferime	-	-	10,545	-	-	-	10,545
Pakesime te tjera	-	-	166	6,877	1,525	-	8,567
31 Dhjetor 2016	-	(31,408,390)	(19,324,278)	(84,104)	(70,466)	-	(50,887,239)
Amortizimi i vitit	-	(1,024,931)	(1,420,662)	(64,222)	(65,201)	-	(2,575,016)
Shtesa kontribut ne kapital	-	-	-	-	-	-	-
Shtesa te tjera	-	(22)	(1,289)	(17,259)	(9,710)	-	(28,280)
Nxjerrje jashte bilanci e aseteve	-	-	-	4,622	-	-	4,622
Nxjerrje jashte perdorimit	-	-	-	-	-	-	-
Transferime	-	-	-	-	-	-	-
Pakesime te tjera	-	22	1,289	17,259	9,710	-	28,280
31 Dhjetor 2017	-	(32,433,322)	(20,744,940)	(143,704)	(135,667)	-	(53,457,634)
Vlera kontabël më:							
1 Janar 2016	1,338,184	57,275,502	30,238,694	197,392	100,271	4,740,209	93,890,254
31 Dhjetor 2016	1,338,184	56,706,352	30,016,440	215,816	122,854	6,154,776	94,554,423
1 Janar 2017	1,338,184	56,706,352	30,016,440	215,816	122,854	6,154,776	94,554,423
31 Dhjetor 2017	1,394,837	57,231,098	29,363,587	226,635	221,815	7,862,651	96,300,623

Në Aktive afatgjata materiale hyjnë mjetet e punës si : Tokat, trojet, ndërtesat, makineritë dhe pajisjet, mjetet e transportit, pajisjet informatike, pajisjet e zyrave, etj.

Aktivët afatgjata materiale më 31 Dhjetor 2017 përfshijnë aktive me një vlerë prej 96,300,623 mijë. Vlera e tyre, si shpenzim shumë vjeçar është shpërndarë midis ushtrimeve vjetore, në përpjestim të drejtë me konsumin e tyre ekonomik të realizuar në çdo vit përkatës, përjashtim nga amortizimi është bërë vetëm tek toka.

Nuk ka ndonjë aktiv të lënë si kolateral deri me 31 Dhjetor 2017.

KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE – KESH SH.A.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur 31 Dhjetor 2017

(Shumat janë të shprehura në mijë Lek)

7. Llogari të arkëtueshme

	2017	2016
Llogari të arkëtueshme kliente	92,301,129	93.168.614
Llogari të arkëtueshme nga punonjësit	37,861	39.049
Llogari të arkëtueshme nga çështja “Jacobsen”	168,173	168.173
Llogari të arkëtueshme nga Shërbimi i Kontrollit të Energjisë Elektrike (“SHKEE”)	862,121	862.121
Të tjera	2,109,595	2.049.338
(Minus : provizioni per renien ne vlere)	(42,735,533)	(42.735.533)
Llogari të arkëtueshme – neto	52,743,347	53.551.762

Provizioni per renien ne vlere ndahet si me poshte:

	2017	2016
Llogari të arkëtueshme kliente	92,301,129	93.168.614
(Minus : provizioni per renien ne vlere)	(42,735,533)	(42.735.533)
Llogari të arkëtueshme kliente neto	49,565,596	50.433.081

Llogari të arkëtueshme nga çështja “Jacobsen”	168.173	168.173
(Minus : provizioni per renien ne vlere)	(168.173)	(168.173)
Llogari të arkëtueshme nga çështja “Jacobsen”	-	-

Llogari të arkëtueshme nga SHKEE	862.121	862.121
(Minus : provizioni per renien ne vlere)	(862.121)	(862.121)
Llogari të arkëtueshme nga SHKEE	-	-

Llogari të arkëtueshme te tjera	2,109,595	2.049.338
(Minus : provizioni per renien ne vlere)	(1,013,417)	(1.013.417)
Llogari të arkëtueshme te tjera	1,096,179	1.035.921

Llogarite e arkëtueshme mund te ndahen me tej ne:

	2017	2016
Familjare	48,985,052	49.378.400
Shoqëri private	580,175	1.054.313
Njësi të kontrolluara nga shteti	369	369
	49,565,596	50.433.081

Grupi nuk ka njohur humbje shtesë për rënien në vlerë të llogarive të tij të arkëtueshme gjatë vitit të mbyllur më 31 Dhjetor 2017. Humbjet ne vlerë janë në shumën 42.735.533 mije lekë. Llogaritë e arkëtueshme të Grupit janë vendosur si kolateral për huatë e marra nga bankat.

KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE – KESH SH.A.
 Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur 31 Dhjetor 2017
 (Shumat janë të shprehura në mijë Lek)

7. Llogari të arkëtueshme (vazhdim)

Instrumentat financiare sipas kategorisë

Politikat kontabël për instrumentet financiarë janë zbatuar ndaj zërave të mëposhtëm:

	2017	2016
Hua dhe të arkëtueshme		
Aktive financiare	20,038,456	21.009.236
Llogari të arkëtueshme e të tjera	52,743,347	53.551.762
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	796,783	805.336
Totali	73,578,586	75.366.334

Detyrime financiare

Llogari të pagueshme e të tjera	13,785,556	18.033.501
Kredi dhe hua	79,944,991	75.587.746
Detyrime të tjera	810,147	810.147
Totali	94,540,694	94.431.394

8. Inventarë

	2017	2016
Materiale të para	1,403,481	1.360.582
Lëndë djegëse	1,117,557	1.128.106
Produkt i gatshëm		
	2,521,038	2.488.688

9. Aktive financiare

	2017	2016
Aktive afat-gjata		
Hua ndaj palëve të treta	12,680,298	14.869.093
Hua ndaj punonjësve	9,780	8.714
	12,690,078	14.877.807
Aktive afat-shkurtra		
Hua ndaj palëve të treta	7,347,095	6.127.798
Hua ndaj punonjësve	1,283	3.631
	7,348,378	6.131.429
	20,038,456	21.009.236

Aktivitet financiarë më 31 Dhjetor 2017 dhe 31 Dhjetor 2016 përfshijnë kredi të dhëna OST sh.a., OSHEE sh.a. dhe EPCG sipas marrëveshjeve respektive dhe kredi të dhëna punonjësve të Grupit.

10. Mjete monetare në arkë e bankë

	2017	2016
Arka	359	495
Banka	816,028	799.316
Para në udhëtim		20.285
Mjete monetare të ngurtësuara BG		
Mjete monetare të ngurtësuara LC	(19,603)	(14.760)
	796,783	805.336

KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE – KESH SH.A.
 Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur 31 Dhjetor 2017
 (Shumat janë të shprehura në mijë Lek)

10. Mjete monetare në arkë e bankë (vazhdim)

Për qëllime të pasqyrës së flukseve të parasë, mjetet monetare në arkë e bankë përfshijnë si vijon:

	2017	2016
Mjete monetare ne arkë dhe bankë	796,783	805.336
Mjete monetare të ngurtësuara BG		
Mjete monetare të ngurtësuara LC	(19,603)	(14.760)
Overdrafte bankare	(33,914,199)	(31.549.739)
	(33,137,019)	(30.759.163)

Overdraft-et janë pjesë e kredive bankare afat-shkurtra në shumën 33.914.199 Lek (2016: 31.549.739 Lek) (Shënimi 13).

11. Kapitali aksioner dhe rezervat

	Totali kapitalit aksioner të regjistruar	Pakësim i kapitalit aksioner të paregjistruar	Totali i kapitalit aksioner
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	20,040,097	(4,000)	20,036,097
Rregjistrim ne QKR i shtesave dhe pakesimeve te parregjistruara			134,125
Gjendja më 31 Dhjetor 2015	20,174,222	(4,000)	20,170,222
Rregjistrim ne QKR i shtesave dhe pakesimeve te parregjistruara			
Gjendja më 31 Dhjetor 2016	20,174,222	(4,000)	20,170,222
Rregjistrim ne QKR i shtesave dhe pakesimeve te parregjistruara			
Gjendja më 31 Dhjetor 2017	20,174,222	(4,000)	20,170,222

Numri total i aksioneve të autorizuar të cilat janë rregjistruar në Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit në datën 31.12.2017 është 20,174,222 aksione me vlerë nominale 1,000 Lekë për aksion. Të gjitha aksionet e emetuara janë plotësisht të paguara.

12. Llogari të pagueshme e të tjera

	2017	2016
Llogari të pagueshme	2,524,092	2.206.785
Llogari të pagueshme ndaj personelit	55,919	50.441
TVSH e pagueshme	(32,482)	3.057.652
Sigurimet shoqërore dhe tatime të tjera	41,994	42.083
Tatim Fitimi	1,273,872	2.117.314
Llogari të pagueshme ndaj SHKEE	236,928	236.928
Dividendë të pagueshëm	1,834,700	1.834.700
Llogari të pagueshme dhe të tjera për tu sistemuar	1,879,720	1.879.720
Llogari te tjera te pagueshme ndaj tatimeve	2,226,031	3.338.761
Të tjera	4,554,929	4.079.265
	14,595,703	18.843.648

KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE – KESH SH.A.
 Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur 31 Dhjetor 2017
 (Shumat janë të shprehura në mijë Lek)

13. Kredi dhe hua

	2017	2016
Afat-gjata		
Kredi dhe hua bankare	9,722,310	13.324.854
Hua nga qeveria	18,810,195	17.156.397
	28,532,506	30.481.252
Afat-shkurtra		
Kredi dhe hua bankare	46,142,543	40.235.032
Hua nga qeveria	5,269,942	4.871.462
	51,412,485	45.106.494
Totali i kredive dhe huave	79,944,991	75.587.746

Totali i huave përfshin huatë dhe kreditë nga bankat dhe qeveria. Huatë nga bankat janë siguruar me garanci nga Qeveria e Shqipërisë.

Ekspozimi i kredive dhe huave të Grupit ndaj ndryshimeve të normës së interesit dhe datave të kontraktuara të rikimit janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2017				
	EUR	USD	CHF	YEN	LEK
Kredi dhe hua bankare	2,91%	5,21%	2,58%	3,22%	-
Hua nga qeveria	2,91%	5,21%	2,58%	3,22%	-

	31 Dhjetor 2016				
	EUR	USD	CHF	YEN	LEK
Kredi dhe hua bankare	3,02%	4,79%	2,60%	3,23%	-
Hua nga qeveria	3,02%	4,79%	2,60%	3,23%	-

Vlerat e drejta për kreditë dhe huatë afat-gjata janë si vijon:

	2017	2016
Kredi dhe hua bankare	9,722,310	13.324.854
Hua nga qeveria	18,810,195	17.156.397
	28,532,506	30.481.252

Vlerat e drejta janë bazuar në flukset e skontuara të parasë duke përdorur një normë të bazuar në normën e kredive dhe huave prej 2,91% p.a. (2016: 3.02% p.a.) për kreditë dhe huatë e shprehura në Euro, 2,58% p.a. (2016: 2,60% p.a.) për kreditë dhe huat e shprehura në CHF, 3,22% p.a. (2016: 3,23% p.a.) për kreditë dhe huat e shprehura në YEN , 5,21% p.a. (2016: 4,79% p.a.) për kreditë dhe huat e shprehura në USD.

Vlerat kontabël të kredive dhe huave afat-shkurtra janë të përafërta me vlerat e drejta.

Vlerat kontabël të kredive dhe huave të Grupit janë shprehur në monedhat e mëposhtme:

	2017	2016
EUR	35,001,687	29.164.209
USD	5,778,506	6.485.111
CHF	2,585,535	2.956.750
YEN	2,766,116	3.065.301
KRW	2,561,368	2.473.128
LEK	31,251,779	31.443.247
	79,944,991	75.587.746

14. Tatimi i shtyrë mbi fitimin

Aktivet dhe detyrimet e tatimit të shtyrë mbi fitimin kompensohen midis tyre kur ka një të drejtë të ligjshme të zbatueshme për të kompensuar aktivet afat-shkurtër tatimore me detyrimet afat-shkurtër tatimore dhe kur tatimet e shtyra mbi fitimin lidhen me të njëjtin autoritet fiskal. Tatimi i shtyrë llogaritet bazuar në normën tatimore të miratuar prej 15% .

	2017	2016
Aktive të shtyra tatimore		
Detyrime të shtyra tatimore	481,696	507.576
Detyrime të shtyra tatimore (neto)	481,696	507.576

Lëvizja bruto në llogarinë e tatimit të shtyrë mbi fitimin është si vijon:

Fillimi i vitit	507,576	635.110
Regjistruar në pasqyrën e të ardhurave	(25,880)	(127.534)
Fundi i vitit	481,696	507.576

Lëvizja në aktivet dhe detyrimet tatimore të shtyra gjatë vitit, pa marrë në konsideratë kompensimin e gjendjeve me juridiksion fiskal të ndryshëm është si vijon:

Detyrime të shtyra tatimore	Kredi dhe hua	Sub-vencio ne	Ndihma	Diferenca të parealizuara këmbimi	Maturuar	Totali
Më 31 Dhjetor 2015	635.110					635.110
Regjistruar në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve	(127.534)	-	-	-	-	(127.534)
Më 31 Dhjetor 2016	507.576					507.576
Regjistruar në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve	(25,880)	-	-	-	-	(25,880)
Më 31 Dhjetor 2017	481,696					481,696

15. Grante

	2017	2016
Grante dhe subvencione	131,152	135.334
Shtesa gjatë vitit		
Pakësime gjatë vitit	(6,923)	
Amortizimi i granteve	(4,611)	(4.182)
Total	119,618	131.152

Subvencionet qeveritare lidhen me sigurimin e shërbimeve dhe aktiveve dhe mund të jenë subvencione drejtpërdrejtë nga qeveria ose nga donatorë të qeverisë shqiptare për aktivitetet e Grupit.

KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE – KESH SH.A.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur 31 Dhjetor 2017

(Shumat janë të shprehura në mijë Lek)

16. Të ardhura

	2017	2016
Energji elektrike	7,194,473	16.423.026
Shërbime	95,414	98.092
Të tjera		
	7,289,888	16.521.118

17. Të ardhura të tjera operative (të ardhura të tjera nga shfrytëzimi)

	2017	2016
Të ardhura nga gjobat mbi pagesat e vonuara	5,679	7.176
Të ardhura nga grantet dhe shërbime të tjera	3,416	1.724
Të tjera	3,914,517	743.874
	3,923,611	752.774

18. Shpenzime personeli

	2017	2016
Shpenzime për paga	649,550	707.676
Kontribut për sigurime shoqërore	117,574	128.141
Kosto stafi të tjera	181,903	204.836
	949,027	1.040.654

19. Shpenzime të tjera

	2017	2016
Shërbime të pajtuara	429,751	297.968
Mirëmbajtje	77,626	51.130
Telefon dhe postë	5,522	6.704
Shpenzime dietash për udhëtime biznesi	35,973	33.501
Komisione bankare	59,855	56.059
Tatime, taksa dhe të ngjashme	7,817	4.470
Gjoha dhe ndëshkime	1,006,355	103.952
Të tjera	314,176	1.188.301
	1,937,076	1.742.086

20. Shpenzime financiare neto

	2017	2016
Shpenzime interesi:		
– kredi dhe hua bankare	1,894,717	1.966.395
– rritje e skontimeve të periudhave të mëparshme		
Shpenzime të tjera financiare		
Fitime neto nga kursi i këmbimit në aktivitetet financiare	(925,777)	(133.573)
Të ardhura interesi nga kredite dhe depozitat bankare	(528,436)	(305.727)
Efekti i njohjes fillestare të detyrimeve financiare të marra jo me norma tregu		
Shpenzime financiare neto	440,504	1.527.095

KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE – KESH SH.A.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur 31 Dhjetor 2017

(Shumat janë të shprehura në mijë Lek)

21. Kreditim i tatimit mbi fitimin

	2017	2016
Tatim fitimi i llogaritur	584,781	755.011
Tatim fitimi i shtyre	(25,880)	(127.534)
	558,901	627.478

Per efekt të deklarimit në organet tatimore të dyja kompanitë (KESH Security shrsf dhe Tec Vlore sh.a.) me kapital të zotëruar 100% nga KESH sh.a. përgatisin dhe deklarojnë formularin vjetor të deklarimit të tatimit mbi të ardhurat.

Tatimi i të ardhurës para fitimit të Grupit ndryshon nga shuma teorike që do të lindë duke përdorur normën tatimore mesatare të ponderuar që zbatohet ndaj fitimeve të shoqërive të konsoliduara si më poshtë:

	2017	2016
Fitimi/(Humbja) para tatimit	506,174	1.786.815
Tatimi i përlogaritur me 15%	75,926	268.022
Shpenzime të panjohura për efekte fiskale	458,132	311.798
Efekti nga aktivet e shtyra tatimore të panjohura	(25,880)	(127.534)
Të ardhura të patatueshme	50,723	175.191
Përdorimi i humbjes tatimore	558,901	627.477

22. Blerje energjie

Blerja e energjisë është si më poshtë:

	2017	2016
Energji e importuar	1,390,970	409.276
Energji e blere nga tregtarët e licensuar te energjise	1,804,392	472.688
Energji e prodhuar në vend nga koncesionet		7.115.374
Energji e prodhuar në vend nga Hec-et e Shkeputura		145.720
OST Disbalancat	451,659	136.450
	3,647,021	8.279.508

Gjatë vitit 2017 Grupi ka importuar energji si dhe ka blerë energji nga tregtarët vendas në bazë të legjislacionit në fuqi dhe modelit të tregut të energjisë elektrike.

KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE – KESH SH.A.
 Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur 31 Dhjetor 2017
 (Shumat janë të shprehura në mijë Lek)

23. Flukset e parasë nga aktivitetet operative

	2017	2016
Fitim/Humbja para tatimit	506,174	1.786.815
Rregullime për:		
–Amortizimin/zhvlerësimet	2,575,095	2.446.125
–Humbje nga daljet nga përdorimi	1,043,003	331.217
–Rënien në vlerë e llogarive të arkëtueshme		
– Fitim/humbje nga rivlerësimi i AAM-ve		
– Të ardhura nga grantet	(4,611)	(4.182)
– Të ardhura nga interesat (Shënimi 20)	(528,436)	(305.727)
– Shpenzime interesi (Shënimi 20)	1,894,717	1.966.395
– Fitim/humbje nga shkëmbimet valutore	(925,777)	(133.573)
– Tatim mbi fitimin	(584,781)	(755.011)
Ndryshimet në Kapitalin qarkullues		
– Inventare	(32,350)	(84.135)
– Llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera	787,931	(422.955)
– Llogari të pagueshme dhe të tjera	(4,538,525)	(1.911.413)
– Mjete monetare të ngurtësuar	(19,603)	(14.760)
Fluksi i Parasë nga aktiviteti operativ	172,835	2.898.796

24. Transaksionet me palët e lidhura

Grupi kontrollohet nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë së Republikës së Shqipërisë, e cila zotëron 100% të aksioneve të shoqërisë.

Transaksionet e mëposhtme janë kryer me palë të lidhura:

	2017	2016
<i>(a) Shitje mallrash dhe shërbimesh</i>		
Shitje mallrash:		
Shitje energjie ndaj njërive shtetërore	7,222,499	12.744.599
Shitje shërbimesh:	-	52.230
	7,222,499	12.796.829
<i>(b) Blerje mallrash dhe shërbimesh</i>		
Njësi të kontrolluara nga shteti	541,991	222.459
Shoqëritë e Ujësjetllësit	4,003	4.192
	545,994	226.650
<i>(c) Subvencione të dhëna</i>		
Demshperblim për permbytjet	503,729	
	503,729	-
<i>(d) Shpërblimi i drejtuesve kryesorë</i>		
Paga dhe shpërblime të tjera afat-shkurtra për punonjësit	55,290	44.231
Këshilli Mbikëqyrës	3,713	3.493
	59,003	47.723
<i>(e) Balancat e fund-vitit me palët e lidhura</i>		
Llogari të arkëtueshme nga palët të lidhura:		
Autoritetet fiskale	330.445	330.445
Njësitë e kontrolluara nga shteti (shënimi 8)	369	369
Njësitë e kontrolluara nga shteti	51,828,219	51.960.137
	52,159,032	52.290.950
<i>Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura</i>		
Ministria e Financave të Republikës së Shqipërisë		
Dividend i pagueshëm	1.834.700	1.834.700
Të tjera	100.858	100.858
Njësi të kontrolluara nga shteti	1,347,613	2.200.775
Autoritetet fiskale (tatime të tjera)	2,251,094	3.363.417
Autoritetet fiskale (TVSH)	32,482	2.846.283
Autoritetet fiskale (TVSH)	-	211.369
Autoritetet fiskale (Tatim fitimi)	1,273,872	2.117.314
Autoritetet fiskale (sigurime shoqërore)	16,931	17.426
	6,857,550	12.692.142
<i>(f) Kredi dhe hua dhene palëve të lidhura</i>		
OST sh.a. OSHEE sh.a	19,683,302	20.519.922
	19,683,302	20.519.922
<i>(g) Kredi dhe hua nga palët të lidhura</i>		
Ministria e Financave të Republikës së Shqipërisë	24,080,137	21.721.099
	24,080,137	21.721.099

25. Angazhime

Angazhime ne qeranë operative – kur një nga Shoqëritë e Grupit është qiramarrëse

Grupi merr me qira zyra dhe magazina të ndryshme me marrëveshje të pa-anulueshme qiraje të zakonshme. Qiratë kanë afate të ndryshueshme, klauzola të përshkallëzimit të çmimeve dhe të drejta ri-përtëritjeje. Grupi nënshkruan kryesisht kontrata një-vjeçare të ripërtëritshme qiraje.

26. Ngjarje pas datës së bilancit

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në cilësinë e pronarit, me Vendimin Nr. 3924/1, datë 26.12.2017, ka vendosur miratimin e Programit Ekonomiko – Financiar të KESH sh.a., si dhe cmimin e shitjes prej 1.5 lekë/KWh për vitin 2018.
- Kontrata e nënshkruar ndërmjet KESH sh.a dhe OST sh.a "Për sigurimin e shërbimit të balancimit për vitin 2018" ka si objekt të saj ofrimin (shitjen) nga ana e KESH dhe sigurimin (blerjen) nga ana e OST e shërbimit të balancimit (kapacitet dhe energji balancuese) që do të përdoret për balancimin e sistemit elektroenergjetik sipas kushteve të përcaktuara në këtë kontratë. Cmimi për sigurimin e kapacitetit të Rezervës së Restaurimit të frekuences (aFRR) në drejtim ulje/ngritje është 270 lekë MW/h ndërsa i kapaciteti të Rezervës Zëvendësuese është 400 lekë MW/h. Cmimi i energjisë balancuese është ai i parashikuar (sipas përlllogaritjeve) në rregulloren e miratuar nga ERE me vendimin nr.193/2017. Kjo kontratë hyn në fuqi pas miratimit nga ERE dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2018 deri më 31 Dhjetor 2018. Kontrata është pëcjellë për miratim në ERE me shkresën nr.1740/2, datë 30.03.2018.
- Në datën 10 Prill 2018, KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a. nënshkruan "Marrëveshjen për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura" në vlerën 51.438.460 mijë lekë.
- Më datën 20 Prill 2018, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, në përputhje me Paragrafin 9.01 të Kushteve dhe Termave Standarte të Marrëveshjes së Huasë dhe Marrëveshjes së Garancisë të ratifikuar me Ligjin Nr.125/2016 "Për projektin "Shqipëria: plani i ristrukturimit të KESH-it", ka njoftuar KESH sh.a. për bërjen efektive të kredisë së dhënë sipas kësaj marrëveshje, duke filluar që prej datës së marrjes së njoftimit.

Sipas parashikimeve të marrëveshjes së mësipërme, paragrafit 2.02 (g) të saj, me bërjen e efektive të marrëveshjes sikurse njoftuar, është në proces disbursimit i transhit të parë prej 118 milion EUR. Nëpërmjet këtij transhi do të mbyllet një pjesë e linjave të huave afatshkurtra (overdrafts) që KESH sh.a ka pranë bankave të nivelit të dytë.

- Me vendimin e datës 14 Maj 2018 "Mbi zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet KESH sh.a dhe OST sh.a, lidhur me korrigjimet e faturave për shërbimin e balancimit sipas parashikimeve të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe përlllogaritjeve nga OST sh.a të rakorduara dhe të pranuara nga palët përgjegjëse për periudhën 1 korrik 2016 – 31 dhjetor 2017", Bordi i ERE vendosi që Shoqëria "OST" sh.a, në çdo rast të bëjë korrigjimet e faturave për shërbimin e balancimit sipas parashikimeve të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe përlllogaritjeve nga OST sh.a të rakorduara dhe të pranuara nga palët përgjegjëse për periudhën 1 korrik 2016 – 31 dhjetor 2017.